



# Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

29 Gusht 2025

## Drejt një Buxheti më të përgjegjshëm gjinor të Kosovës 2026

E nderuar Sekretare e Përgjithshme znj. Fahrije Tërnavaj,

E nderuar Drejtore e Departamentit për Buxhet dhe Financa znj. Drita Xheladini,

Po ju shkruaj në emër të Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), për të kërkuar që të shqyrtohen me prioritet kërkesat buxhetore për Ministrinë e Punëve të Brendshme për vitin 2026. Siç mund të jeni të informuar, buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) synon të sigurojë që fondet të planifikohen dhe të shpenzohen për të adresuar nevojat e ndryshme të grave, burrave, djemve dhe vajzave të identifikuara përmes analizës gjinore. Sipas Ligjit të Kosovës [Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore](#), BPGJ është i detyrueshëm për të gjitha institucionet publike. Mospërmbushja e këtij obligimi, siç përcaktohet nga ky Ligj, përbën një shkelje ligjore dhe është e dënueshme me sanksione. Për më tepër, Qeveria ka interes në zbatimin e buxhetimit gjinor në kuadër të [përkushtimeve të saj ndaj Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara \(OZHQ\)](#), konkretisht [OZHQ 5, treguesi 5.c.1; Korniza Suplementare e Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjësiwe Financiare për vlerësimin e menaxhimit financiar publik të përgjegjshëm gjinor \(PEFA GRPFM\)](#) dhe, më e rëndësishmja, si një praktikë e mirë në menaxhimin financiar. Zbatimi i BPGJ-së mund të kontribuojë në një shpenzim më efektiv, të përgjegjshëm dhe transparent të burimeve qeveritare, përfshirë edhe drejt arritjes së barazisë gjinore. Prandaj, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmes [qarkores buxhetore](#), ka kërkuar që të gjitha organizatat buxhetore të përfshijnë një shtojcë në kërkesat e tyre për ndarjen buxhetore duke shpjeguar se si buxheti i tyre për vitin 2026 siguron BPGJ-në.

Qeveria të përfshijë zyrtarët për barazi gjinore nga entitetet qeveritare dhe organizatat e shoqërisë civile në konsultimet publike që lidhen me buxhetin, siç kërkohet nga [Rregulloria \(QRK\) Nr. 12/2016 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Zyrtarëve Përkatës për Barazi Gjinore Në Ministri dhe Komuna](#) si dhe [Rregulloria \(QRK\) - Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës](#). Për të mbështetur Qeverinë në zbatimin e përgjegjësiwe të saj, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), një rrjet prej 102 organizatash të ndryshme për të drejtat e grave, ka përgatitur këtë letër me rekomandime për përmirësimin e BPGJ-së në lidhje me Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2026. Rekomandimet bazohen në hulumtimet dhe evidencat e RrGK-së për nevojat:

- **Të rritet mbrojtja e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore dhe të parandalohet përsëritja e rasteve të dhunës me bazë gjinore përmes ndarjes së fondeve për blerjen dhe mirëmbajtjen e sistemeve të mbikëqyrjes elektronike, përfshirë byzylykët elektronikë.** Këto janë thelbësore për monitorimin e kryerësve të dhunës dhe sigurimin që ata t'i përmbahen urdhrave mbrojtës, duke ofruar një shtresë shtesë sigurie për të mbijetuarit, në përputhje me [Ligjin Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të Cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës](#).
- Të planifikohet buxhet dhe të organizohet **trajnim i përbashkët për zyrtarët e Policisë së Kosovës për t'u specializuar në siguri kibernetike dhe dhunë me bazë gjinore**, me qëllim të koordinimit më të mirë në trajtimin e rasteve të krimit kibernetik me bazë gjinore.
- Të bëhet ndarje e mjaftueshme buxhetore për të siguruar që **platforma e planifikuar për sigurinë kibernetike të mbledhë të dhënat e ndara sipas gjinisë për personat që e përdorin atë, të garantojë konfidencialitetin, të mbrojë standardet etike**, të sigurojë mbrojtjen e të dhënave dhe të ketë një ndërfaqe të lehtë për përdorim që përfshin mekanizma referimi përmes të cilëve përdoruesit mund të paraqesin ankesa.
- Të planifikohet buxhet për **thelimin e info-qendrave me kompjuterë falas, të sigurt dhe publikisht të qasshëm në komuna, si p.sh. në biblioteka dhe zyra publike, për të lehtësuar qasjen në shërbimet publike online për gra dhe burra nga grupe të ndryshme**. Këto [masa](#)

do të ndihmojnë në adresimin e pengesave gjinore dhe ndër-sektoriale, si mosha dhe etnia, që ndikojnë në qasjen në shërbimet digjitale. Po ashtu, të planifikohet buxhet për **trajnimin e stafit** që do të ndihmojë në përdorimin e softuerëve online për qasje në shërbime publike dhe të ndahen subvencione për **kontraktimin e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) ose bizneseve** të kualifikuara për ofrimin e këtyre shërbimeve, përfshirë vizitat derë më derë për të mbështetur përdorimin e shërbimeve publike digjitale

- Të ndahen fonde të mjaftueshme për **trajnimin e të gjithë zyrtarëve policorë në komunikim ndërsektorial, të ndjeshëm ndaj gjinisë dhe konfliktit.**

RrGK fuqimisht i bën thirrje Ministrisë së Punëve të Brendshme që të zbatojë këtë rekomandim, për institucionalizimin e BPGJ-së në Kosovë, në përputhje me angazhimet ekzistuese, dhe për një Buxhet më të përgjegjshëm gjinor për vitin 2026. Ne gjithashtu ju inkurajojmë fuqimisht që të publikoni shtojcën e Buxhetit të vitit 2026 të Ministrisë suaj, të kërkuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe në përputhje me OZHQ 5, treguesi 5.c.1; duke shpjeguar në mënyrë transparente se si buxheti juaj për vitin 2026 do të kontribuojë në avancimin e barazisë gjinore dhe shpenzimet përkatëse të parashikuara.

Ju faleminderit për bashkpunimin tuaj të vazhdueshëm.

Sinqerisht,  
Igballe Rogova  
Drejtoresh Ekzekutive  
Rrjeti i Grave të Kosovës